



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA VUSHTRRI



---

ZYRA E KRYETARIT

# Draft PLAN

---

## I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË

Zyra e Komunikimit me Publikun

2018

# Hyrje

Transparenca e plotë në punën e administratës lokale dhe Kuvendit Komunal është parakusht për qeverisje të mirë dhe pjesëmarrje të publikut në krijimin e politikave publike, për një qeverisje të mirë.

Si në të kaluarën, Komuna e Vushtrrisë vazhdon të jetë e përkushtuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.

Duke u bazuar në Rregulloren për transparencë të Komunës së Vushtrrisë, të miratuar në Kuvendin Komunal 01 Nr. 99/13 të datës 25 04 2013 dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 01\2015 për Transparencë në Komuna, Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, miraton këtë Plan të Veprimit për Transparencë.

## 1. Plani i Veprimit për Transparencë i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018

Nr.	Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve e komunës
1	<b>Mbledhje të hapura të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve</b>	Njoftim për mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal dhe Komiteteve në: Ueb faqen zyrtare Në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës Në media të shkruara dhe elektronike Rrjete sociale	Sekretaria e Kuvendit përmes Zyrës për komunikim me publikun njofton qytetarët së paku shtatë ditë pune para mbajtjes së mbledhjeve	Salla e Kuvendit Komunal / Komiteteve	
2	<b>Takimet e kryetarit me publikun</b>	Kryetari i Komunës së Vushtrrisë mban së paku dy takime publike – raportim për punën e ekzekutivit	Zyra e Kryetarit, përmes zyrtarit për komunikim me publikun njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimeve publike si dhe dëgjimeve të ndryshme edhe atë në Ueb faqen zyrtare, në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës,	Salla e Kuvendit apo salla tjera alternative	Njoftimi 2 javë para mbajtjes

Nr.	Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve të komunës
			në media të shkruara dhe elektronike, rrjete sociale		
3	<b>Konsultimet me publikun dhe fokus grupet</b>	Komuna e Vushtrrisë organizon konsultime të ndryshme që janë në interes të qytetarëve dhe që lidhen me buxhetin komunal, zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin hapësinor dhe çështje tjera me rëndësi për interesin e përgjithshëm të publikut	Sekretaria Kryetarit, përmes Zyrtarit për komunikim me publikun njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimeve publike si dhe dëgjimeve të ndryshme edhe atë në Ueb faqen zyrtare, në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës, në media të shkruara dhe elektronike dhe në rrjete sociale	Salla e Kuvendit Komunal apo salla tjera alternative	Njoftimi 2 javë para mbajtjes
4	<b>Konferencat për media të Kryetarit dhe Drejtorive Komunale</b>	Kryetari i Komunës së Vushtrrisë dhe drejtorët e Drejtorive komunale mbajnë konferenca për media, të paktën dy herë brenda vitit.	ZKP fton mediat dhe publikon njoftimin në ueb faqe zyrtare dhe faqen zyrtare të Komunës në rrjetin social Facebook.	Salla e konferencave	

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Nr.	Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve të komunës
5	<b>Takimet e Kryetarit me qytetarë, shoqërinë civile, OJQ dhe gazetarë</b>	Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, në kuadër të kompetencave të tij, realizon takime në formë debati me qytetarë, OJQ dhe gazetarë	Debatet e tilla i organizon Kabineti i Kryetarit, duke siguruar hapësirë të mjaftueshme për pjesëmarrje.	Zyra e Kryetarit ose salla tjera alternative	
6	<b>E drejta e qasjes në dokumente publike</b>	Për të qenë sa më transparent ndaj publikut, Komuna e Vushtrrisë, bënë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike, të aprovuara nga organet e Komunës dhe i adreson ato në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike	Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet publike  Drejtoritë dhe zyrat përkatëse që i posedojnë dokumentet		7-15 ditë
7	<b>Kërkesat për informim, iniciativat qytetare dhe petitionet</b>	Subjekti fizik ose juridik ka të drejtë të parashtojë kërkesë në Komunën e Vushtrrisë, për realizimin e iniciativave qytetare dhe petitioneve	Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës, Kryetari, Drejtoria, Njësia apo zyrtari për komunikim me qytetarë, jo më vonë se 15 ditë nga dita e		15 ditë

Nr.	Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve të komunës
		për çështje që janë në përgjegjësi të organeve komunale	shqyrtimit, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit		
8	<b>Publikimi i akteve komunale</b>	Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentet tjera të Kuvendit Komunal të Vushtrisë, publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun	Sekretaria e Kuvendit përmes Zyrës për Komunikim me Publikun, publikon aktet komunale në ueb faqen zyrtare		
9	<b>Publikimi i buxhetit dhe shpenzimeve buxhetore të Komunës</b>	Publikohet planifikimi buxhetor sipas buxhetit të miratuar nga Kuvendi Komuna. Publikohen raportet buxhetore të të hyrave dhe shpenzimeve të Komunës çdo 3 muaj	Drejtoria e buxhetit dhe financave ZKP		

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Nr.	Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve të komunës
10	<b>Publikimi i vendimeve të kryetarit të Komunës</b>	Të gjitha aktet të cilat i miraton kryetari i Komunës së Vushtrrisë, publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun	Zyra e kryetarit të Komunës në bashkëpunim me Zyrën për Komunikim me Publikun		
11	<b>Mirëmbajtja dhe freskimi i ueb faqes zyrtare të Komunës</b>	Ueb faqja zyrtare e Komunës së Vushtrrisë freskohet me dokumente, informacione dhe lajme nga aktivitetet e përditshme të ekzekutivit dhe Kuvendit Komunal, si dhe dokumente tjera publike sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2015.	Përgjegjëse për këtë është Zyra për Komunikim me Publikun dhe IT		
12	<b>Shfrytëzimi i rrjeteve sociale</b>	Komuna e Vushtrrisë ka faqen zyrtare në rrjetin social Facebook, ku publikohen të gjitha informatat e Kuvendit të Komunës dhe ekzekutivit	Përgjegjëse për këtë faqe është Zyra për Komunikim me Publikun		

Nr.	Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve të komunës
13	Qasje e lehtë e qytetarëve në informacione lidhur me shërbimet që kryen komuna	Komuna e Vushtrrisë publikon në ueb faqe udhëzuesin lidhur me të gjitha shërbimet që ofron, publikon formularët për ofrimin e shërbimeve për qytetarë, siç janë: certifikata e lindjes, certifikata e vdekjes, certifikata e kurorëzimit etj	Zyra e kryetarit, Drejtoritë		
14	<b>Prokurimi transparent</b>	Drejtoria e Prokurimit i publikon në Ueb faqen zyrtare të Komunës, në afate ligjore, të gjitha njoftimet për kontrata, njoftimet për dhënie të kontratave, njoftimet për konkurse të projektimit dhe njoftimet për vazhdim të afatit.	Përgjegjës për publikim të tyre në ueb faqe është Drejtoria e Prokurimit, ZKP dhe IT		Sipas afateve ligjore



Nr.	Objektivat e planit të veprimit	Aktivitetet e planit të transparencës	Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës	Vendi i mbajtjes së aktiviteteve	Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve të komunës
15	<b>Transparenca në procedurat e punësimit</b>	Zyra e Personelit e Komunës së Vushtrrisë është përgjegjëse për publikim në ueb faqe dhe media të shkruara e elektronike të konkurseve, njoftimeve për përzgjedhjen e kandidatëve, njoftimeve për anulim të konkurseve, rishpalljen apo vazhdimin e afateve, avancimet brenda institucionit si dhe aplikacionet për punësim.	Zyra e Personelit në bashkëpunim me Zyrën e IT –së		Sipas afateve ligjore

01.-----

Vushtri, më 26. 07. 2018

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Nasuf Aliu